




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjiilan, me datë: 15.03.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjiilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. **13.03.2023** të parashtruar nga: *OE “NAS SYSTEMS SH.P.K “ & OE “RED by Besa Secyrity LLC “, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me sistemin e kamerave digjitale në QKMF,QMF dhe AMF “, me nr.identifikues 651-23-395-1-3-6 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 23 06 136*^{nxjerr}:

V E N D I M

1. **Refuzohet** – kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorëve Ekonomikë “NAS SYSTEMS SH.P.K “ & OE “RED by Besa Secyrity LLC “, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me sistemin e kamerave digjitale në QKMF,QMF dhe AMF “, me nr.identifikues 651-23-395-1-3-6 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 23 06 136 të datës **13.03.2023** Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës **08.03.2023** të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.
2. **AK - Komuna e Gjiilanit** vendosë të vazhdojë sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës **08.03.2023**.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatorët Ekonomikë “NAS SYSTEMS SH.P.K “ & OE “RED by Besa Secyrity LLC “, me datë **10.02.2023**, kanë parashtruar kërkesën e tij për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me sistemin e kamerave digjitale në QKMF,QMF dhe AMF “ me nr.identifikues 651-23-

395-1-3-6 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 23 06 136. Autoriteti Kontraktues me datë 06.10.2022 ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga Operatorët Ekonomikë “NAS SYSTEMS SH.P.K “ & OE “ RED by Besa Secyurity LLC “, Autoriteti Kontraktues - Kuvendi Komunal Gjilan ka konstatuar se pretendimet e juaja janë të pa bazuara pasi që:

Ne si AK – Autoritet Kontraktues kemi bërë publikimin e DT si dhe Njoftimit për Kontratë me dt. 01.02.2023.

Në kërkesën e OE ë saktësisht tek pretendimet ankimore që ka ngritur si çështje është që A i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura nga AK ne dosje të tenderit, dhe 2. A janë pajisjet konform vendimit 07/66 të Qeverisë së Kosovës ku janë vendosur sanksione ndaj disa brendëve duke përfshirë edhe brende që janë kocka të famshme në Kosovë sa i përket kamerave - vendim që ka ardhur si rrjedhojë e vendimeve të OKB, BE dhe SHBA (lista e brendëve të ndaluara gjendet në linkun në vijim, ndërsa vendimi i qeverisë në fund të këtij dokumenti <https://blink.ucsd.edu/technology/security/ndaa/index.html>)

Ne dosje të tenderit ju keni specifikuar karakteristikat teknike të detyrueshme në Aneksin 1, mbi bazën e të cilës ne si OE kemi përpiluar ofertën, mirëpo OE i perzgjedhur për kontratë nuk ka dorëzuar asnjë dokument, specifikacion apo broshurë të produkteve/brendit të ofertuar. Duke u referuar në këtë kërkesë, ju si AK nuk keni bërë vlerësim teknik të ofertës apo nuk keni informacion se çfarë prodhuesi apo brendi të pajisjeve do të pranoni. Për më tepër, duke ju referuar Rregullores të KRPP-së, nr.001/2022, e cila ka hyrë në fuqi me datë 01.11.2022, nenit 19 Specifikimet Teknike, paragrafi 19.7 dhe 19.8, obligohet që AK-ja të mos specifikojë apo pranojë produkte të brendëve që janë në listën e sanksioneve të Qeverisë së Kosovës apo të shteteve aleate sic janë SHBA, EU, NATO, etj.

Andaj, kërkojmë nga ju si AK të ktheni lenden në rishqyrtim, të kërkojë nga OE që të dorëzojë informacione sipas specifikave teknike të kërkuara nga ju në Aneksin 1 dhe të bëjë vlerësim të drejtë të tendereve sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe Rregullores së KRPP-së. Në të kundërtën, çdo vendim i juaji që nuk respekton këtë kërkesë dhe vendime tjera duke shkelur dispozitat ligjore të LPP-së, do të jemi të detyruar të drejtojmë ankesën tonë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit

Përgjigjia e AK lidhur me këto pretendime është se:

Komisioni Profesional për Egzaminimin dhe Vlerësimin e Ofertave në bazë të LPP-së dhe RROUPP ka vlerësuar në bazë të Kriterëve që janë të specifikuar në DT si dhe në Njoftimin për Kontratë.

Autoriteti Kontraktues (AK) - në harmoni me Nenin 1 Qëllimi, Nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti dhe Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi ka hartuar DT duke specifikuar kriteret të cilat nuk e kufizojnë konkurrencën nuk diskriminon kundër ose vepron në favor të ndonjë OE.

Duke parë pretendimet tuaja Ankimore ne si AK kemi shqyrtuar në detaj këto të fundit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Shqipe Hoxha



Menaxhere e zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës.